THE FORMATION OF ADJECTIVES IN ISMAIL KADARE'S NOVEL *THE GENERAL OF THE DEAD ARMY*

FORMIMI I MBIEMRAVE NË ROMANIN "GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR" TË ISMAIL KADARESË

Selvije SELMANI[1]

Primary School "Simche Nastovski", Municipality of Jegunovce
Corresponding author e-mail: selmaniselvije@gmail.com

Abstract

The adjective is one of the parts of speech characterized by the diversity of word-formation patterns in the Albanian language. This diversity is also reflected in the literary works of Ismail Kadare, one of the most prominent representatives of Albanian literature. This study focuses on the formation of adjectives in the novel *The General of the Dead Army*, aiming to identify the word-formation patterns and the elements involved in their formation.
The novel features adjectives formed through prefixation, suffixation, the use of a preposed article, as well as through the combination of prefixation and suffixation. The analysis of prefixal formations focuses on the prefix *pa-*, while suffixal formations are examined in relation to the suffixes *-al, -ës, -(ë)sor, -ik, -onjës, -or(e), -shëm, -ueshëm, -tar and -iv*. Particular attention is also given to formations involving a preposed article and to cases involving the suffixes *-të, -ët* and *-t*. The analysis also includes formations based on nouns, verbs and adverbs, as well as adjectives derived from verb participles, with particular emphasis on the role of the article in these formations.
The analysis shows that the prefix *pa-* is relatively productive in prefixal formations, while the suffix *-shëm* stands out for its productivity in formations involving both the use of a preposed article and suffixation. These findings highlight the diversity of word-formation patterns and devices employed in the formation of adjectives in this novel.

Keywords: *adjective, word formation, prefixation, suffixation, preposed article, Ismail Kadare*.

Abstrakt

Mbiemri është një nga pjesët e ligjëratës që dallohet për larminë e mënyrave të formimit në gjuhën shqipe. Kjo larmi pasqyrohet edhe në veprën e Ismail Kadaresë, njërit prej përfaqësuesve më të njohur të letërsisë shqipe. Studimi përqendrohet në formimin e mbiemrave në romanin "*Gjenerali i ushtrisë së vdekur"*, me synimin për të evidentuar mënyrat fjalëformuese dhe elementet që marrin pjesë në krijimin e tyre.
Në roman dallohen formime me parashtesim, prapashtesim, paranyjëzim, si dhe me ndërthurjen e parashtesimit dhe prapashtesimit. Në grupin e formimeve me parashtesim shqyrtohet parashtesa *pa-*, ndërsa në formimet me prapashtesim analizohen prapashtesat *-al, -ës, -(ë)sor, -ik, -onjës,-or(e), -shëm, -ueshëm, -tar* dhe *-iv*. Një vend të veçantë zënë formimet me paranyjëzim dhe ato me prapashtesat *-të, -ët* dhe *-t*. Në analizë përfshihen edhe temat fjalëformuese emërore, foljore dhe ndajfoljore, si dhe mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve, duke vënë në pah rolin e nyjës në këto formime.
Nga analiza rezulton se parashtesa *pa-* është mjaft prodhimtare në formimet me parashtesim, ndërsa prapashtesa *-shëm* dallohet për prodhimtari në formimet me paranyjëzim dhe prapashtesim. Këto të dhëna dëshmojnë larminë e mënyrave dhe të mjeteve fjalëformuese të përdorura në krijimin e mbiemrave në këtë roman.

Fjalë kyçe: *mbiemër, fjalëformim, parashtesim, prapashtesim, paranyjëzim, Ismail Kadare.*

Hyrje

Fjalëformimi përbën mënyrën kryesore të pasurimit të leksikut në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër, mbiemri shfaq një larmi të madhe tipash fjalëformues, si: parashtesimi, prapashtesimi, paranyjëzimi, si dhe ndërthurja e tyre dhe nyjëzimi i pjesoreve.

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp103

Objekt i këtij punimi është analiza fjalëformuese e mbiemrave në romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të Ismail Kadaresë. Analiza e këtyre formimeve ndihmon në evidentimin e mënyrave më produktive të fjalëformimit mbiemëror në këtë vepër.
Synimet kryesore të punimit janë:

- Klasifikimi i mbiemrave të romanit sipas mënyrës së formimit dhe përcaktimi i temave fjalëformuese (emërore, foljore, ndajfoljore).
- Evidentimi i prodhimtarisë së parashtesave dhe prapashtesave, ku parashtesa *pa-* dëshmon shkallën më të lartë të produktivitetit te parashtesimi, kurse prapashtesa *-shëm* te paranyjëzimi e prapashtesimi.
- Analiza e rolit të nyjës në mbiemërzimin e pjesoreve të foljeve.
- Sqarimi i dallimit teorik mes formimeve parashtesore mbiemërore dhe mbiemërzimit të pjesoreve (p.sh., *të përthyera*, *të zhveshura*).
- Identifikimi i formimeve me prodhimtari të ulët, kompozitave dhe rasteve të derivacionit analogjik.

Për analizën dhe interpretimin e të dhënave, ky studim i referohet literaturës dhe kritereve teorike të vendosura nga gjuhëtarët tanë në fushën e fjalëformimit (E. Çabej, A. Dhrimo, J. Thomai, F. Agalliu etj.).

Formimi i mbiemrave me parashtesën *pa-*

Parshtesa pa- është me origjinë parafjalore me të cilën formohen mbiemra me funksion mohues, përjashtues prej mbiemrave të nyjshëm (Dhrimo,1972:54)
Parashtesa *pa-* është mjaft prodhimtare në formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe, poashtu edhe në romanin në fjalë. Mbiemrat me këtë parashtesë kryesisht formohen nga tema mbiemërore me paranyjëzim të pjesores ose paranyjëzimit e prapashtesës *-shëm.*
Mbiemra të formuar me parashtesën *pa-,* që kanë si temë fjalëformuese një mbiemër të prejardhur nga një emër, dëshmohen shembujt, si: *e pafuqishme, të parëndësishme, të parrezikshme*.
e pafuqishme (… cigarja e tij iu duk e vogël dhe ***e pafuqishme*** përpara çibukëve të mëdhenj ...) f.191
të parëndësishme (… ata bisedonin për gjëra të ndyshme dhe ***të parëndësishme*** …) f.9
të parrezikshme (… vërtet është një çast i lumtur për ushtarët të ecnin në rrjesht së bashku, një natë vere, në një xhade ***të parrezikshme*** …) f.105
Mbiemra të formuar me parashtesën *pa-,* që kanë si temë fjalëformuese një mbiemër të prejardhur me paranyjëzim të pjesores, si: *e pabanuar, të palarë, e pandarë, të panjohur, të papërcaktuar, të papërqëndruar, të paprishur, të parrojtur, e pashkelura*.
e pabanuar (… kjo zone, që këndej e gjer në det, është ***e pabanuar*** …) f.149
të palarë (… ne ishim të rraskapitur, ***të palarë*** dhe të mëzitur …) f.105
të pamundur (… duke imagjinuar gjënë më ***të pamundur***: kthimin e disfatave në fitore …) f.134
e pandarë (… kështu që pushka bëhet pjesë ***e pandarë*** e jetës së tyre …) f.27
të panjohur (… ku njerëz ***të panjohur*** bëjnë radioskopi dhe pastaj ikin …) f.30
të papërcaktuar (… ai tundi disa herë kokën e përshëndeti në drejtim ***të papërcaktuar*** …) f.187
të papërqëndruar (… plaka Nicë qëndroi në vend, i nguli gjeneralit një vështrim ***të papërqëndruar*** …) f.201
të paprishur (… ju ka qëlluar të gjeni trupa ***të paprishur***? …) f.53
të parrojtur (… menjëherë u gjallëruan të gjithë dhe ashtu, siç ishim, ***të parrojtur*** e të ***langosur*** me baltë …) f.105

e pashkelura (… si kish mundur të futej ushtari në labirintet ***e pashkelura*** të kalasë dhe pse? …) f.25

Këto formime përbëjnë grupin më të madh të mbiemrave me *pa-,* në gjuhën shqipe. Rritja e vargut të formimeve mbiemërore të këtij lloji shpjegohet, nga njëra anë, me shtimin e madh të mbiemrave prejpjesorë, të cilët shërbejnë në këtë rast si tema fjalëformuese, dhe nga ana tjetër, me faktin se mundësia e formimit të këtij tipi mbiemrash parashtesorë është po aq e pakufizuar sa edhe ajo e mbiemrave prejpjesorë (Feka, 1994:45).

Mbiemra të formuar me parashtesën *pa-,* që kanë si temë fjalëformuese një mbiemër të prejardhur foljor me prapashtesë, si: *të pabesueshme, të pagabueshme, të pakuptueshëm, të palëvizshëm, i pazgjidhshëm.*

të pabesueshme (… sepse ishte kohë lufte dhe dëgjonim lloj-lloj gjërash nga më ***të pabesueshmet*** …) f.58

të pagabueshme (… i pajisur me harta e shënime ***të pagabueshme*** …) f.11

të pakuptueshëm (… si një ekran që vazhdimisht merr të njëjtin program, krejt ***të pakuptueshëm*** …) f.23

të palëvizshëm (… tek vështronte vjedhurazi profilin e ngurtë dhe ***të palëvizshëm*** të priftit …) f.20

i pazgjidhshëm (… rrotullohej e rrotullohej dhe bëhej kular rreth maleve si një lëmsh ***i pazgjidhshëm*** …) f.177

Mbiemra të formuar nga një temë foljore me anë të paranyjëzimit, të parashtesës *pa-* e të një prapashtese njëkohësisht, si: *e papërshtatshme, të paaritshme*.

e papërshtatshme (… koha është vërtetë ***e papërshtashme***, por, siç duket, s'ka pasur mundësi më pare …) f.79

të paarritshme (njeriut shpesh i qëllon të ëndërrojë gjëra ***të paarritshme*** …) f.230

Mbiemër i formuar me parashtesën ***pa-,*** që ka si temë fjalëformuese një mbiemër të parmë është hasur mbiemri *të pasigurta*.

të pasigurta (… aty-këtu nëpër cepat e horizontit, të lehta e ***të pasigurta*** dridheshin njollat e para të mbrëmjes …) f.74

Formimi i mbiemrave me prapashtesën *-ës, -(ë)sore*

Në romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të Ismail Kadaresë, prapashtesat *-ës* dhe *-ësor* përdoren në formimin e mbiemrave me tema fjalëformuese foljore dhe emërore. Për prejardhjen e prapashtesës *-ës* janë shfaqur mendime të ndryshme në gjuhësi. Boppi pranon se *-s* buron nga një *-tj*, së cilës i përgjigjet prapashtesa greke *-ont*. Ndërkaq, Pederseni mendon se prapashtesa *-ës* ose *-s* nuk rrjedh nga pjesorja e së tashmes me *-ont*, por i afrohet prapashtesës së armenishtes *-iç*, e cila ka të njëjtin funksion (Çabej, 1987: 230).

Në roman, tema foljore *ngjeth* dhe *trondit* shërbejnë si bazë për formimin e mbiemrave *ngjethës* dhe *tronditës*.

ngjethës (… duke u fërkuar me ta lëshonte një tingull ***ngjethës*** …). f.15

tronditëse (… larg në fushë ishte po ajo bardhësi ***tronditëse*** e hënës …) f.48

Me parapashtesën *-(ë)sore* nga temat fjalëformuese emërore *armik* dhe *paqe* janë formuar mbiemrat *armiqësor* dhe *paqësor*.

armiqësore (…pamjen kërcënonjëse e ***armiqësore*** të maleve qe munduar ta luftonte …), f.8

paqësore (ajo i kish mbuluar me një cipë të bukur, të bardhë ***e paqësore*** …) f.176

Formimi i mbiemrave me prapashtesën -or(e)

Prapashtesa -*or(e),* e lidhur me tema fjalëformuese emërore, ka shërbyer për formimin e mbiemrave: *madhështor (madhështi), ndëshkimor (ndëshkim), njerëzore (njerëzi), malore (mal), shoqërore (shoqëri), verore (verë) dhe veriore (veri).*
madhështor (... po aq ***madhështor*** u kthye ...) f.10
ndëshkimor (... vetë tanët i kishin varrosure shpejt e shpejt; një batalion ***ndëshkimor*** yni ...) f.237
njerëzore (... në një mënyrë ose në një tjetër bisedat ***njerëzore*** ...) f.24
shoqërore (... u shmangeshin bisedave politike dhe ***shoqërore*** ...) f.10
malore (... shoferi i kamionit e pa i pari veturën që po ngjitej me zor nëpër xhadenë ***malore*** ...) f.169
verore (... tani nuk dukeshin më as stacionet ***verore*** të hekurudhës ...) f.147
veriore (... në muajt më të nxehtë bënë kërkime alpet ***veriore*** ...) f.157
shoqërore (... u shmangeshin bisedave politike dhe ***shoqërore*** ...) f.10

Formimi i mbiemrave me paranyjëzim dhe prapashtesën *-shëm, -ueshëm*

Formimi i mbiemrave përmes nyjëzimit dhe prapashtesimit, veçanërisht me prapashtesën -*shëm*, paraqitet si një dukuri mjaft prodhimtare në romanin "*Gjenerali i ushtrisë së vdekur"* të Ismail Kadaresë. Sipas Haxhillazit (1969:145), prapashtesa -*shëm* bën pjesë ndër prapashtesat kryesore që shërbejnë për formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe. Prodhimtaria e saj lidhet si me numrin e madh të mbiemrave që formohen, ashtu edhe me larminë e temave fjalëformuese që marrin pjesë në këtë proces. Këto tema mund të jenë emërore, ndajfoljore ose foljore (Agalliu et al., 2002:193). Përdorimi i mbiemrave të formuar me këtë prapashtesë në romanin e Kadaresë paraqet interes për të shqyrtuar mënyrën se si ky element fjalëformues pasqyrohet në gjuhën e veprës.
Në formimin e mbiemrave në këtë roman, si tema fjalëformuese emërore shërbejnë emrat: *frikë, fuqi, guxim, lyrë, ndërgjegje, njerëzi, sipërfaqe, sjellje, rrezik, tmerr* dhe *turp*.
të frikshme (... në pamjen e tyre s'kishte asgjë ***të frikshme*** ...) f.16
të fuqishme (... tamam në atë kohë kur pushtonjësit me popma ***të fuqishme*** lanin gjakun nëpër rrugët e Durrësit ...) f.152
të guximshëm (... ishin duke shkruar një artikull mjaft ***të guximshëm*** ...) f.25
i lyrshëm (... tani qielli duke si ***i lyrshëm*** dhe, bashkë me të, horizontet, fusha ...) f.46
të ndërgjegjshme (... nuk është punë trimërie ***të ndërgjegjshme*** ...) f.26
të njerëzishëm (... tha prifti me një ton ***të njerëzishëm*** ...) f.23
e sipërfaqshme (... vërtet dukej sikur gjendja po normalizohej, por kjo ishte një gjë e ***sipërfaqashme*** ...) f.200
i sjellshëm (... Gjenerali ishte shumë serioz dhe ***i sjellshëm*** ...) f.10
të rrezikshme (... ky ishte gëzimi i udhëtarit që gjen një strehë, pas një udhe ***të rrezikshme*** ...) f.10
e tmerrshme (... ishte ***e tmerrshme***? ...) f.15
e turpshme (... do të ishte shumë ***e turpshme*** dhe e trishtueshme ...) f.26
Mbiemrat e formuar nga tema foljore që mbarojnë me bashkëtingëllore kanë si temë fjalëformuese pjesoren e foljes, pa prapashtesat -*r(ë)* ose -*ur*. Në këtë grup bëjnë pjesë mbiemrat e formuar nga foljet: *bezdis, çudit, ndrit, ngjaj* dhe *mërzis*.
të bezdisshme (... gazetarët i kishin bërë shumë pyetje të ***bezdisshme*** në lidhje me kohën ...) f.157
e çuditshme (... një gjë ishte ***e çuditshme***: si kish mundur të futej ushtari ...) f.25

e ndritshme (... atij pi i merreshin mendtë nga kjo furi e tërbuar, e rrezikshme dhe ***e ndritshme*** ...) f.195
e ngjashme (... gjeneralit iu kujtua një ëndërr e tij, pak a shumë ***e ngjashme*** ...) f.55
të mërzitshme (... kam vënë re se bisedat tona i ngjajnë dialogëve ***të mërzitshme*** ...) f.23
Si tema fjalëformuese ndajfoljore në formimin e këtyre mbiemrave shërbejnë ndajfoljet *brenda* dhe *sot*.
e brendshme (... shtyu derën ***e brendshme*** dhe e lëshoi thesin në tokë ...) f.204
të sotshëm (... ju pëlqen teatri ***i sotshëm***? ...) f.24
Në materialin e analizuar janë gjetur dy mbiemra të formuar me prapashtesën *-ueshëm* nga folje me temë në *-o*. Në këtë mënyrë formimi, siç vëren edhe Agalliu (2002:193), si temë fjalëformuese shërben vetë tema e foljes, duke rënë prapashtesa *-o* e saj.
i këmbueshëm (... pastaj zëri i tij u bë më i kumbueshëm dhe mi i thellë e solemn ...) f.214
e trishtueshme (... do të ishte shumë e turpshme dhe e ***trishtueshme*** ...) f.26

Formimi i mbiemrave me nyjëzim, parashtesim e prapashtesim njëherazi

Kjo mënyrë fjalëformimi ka prodhimtari shumë të kufizuar (Agalliu et al., 2002: 197).
Materiali i romanit e vërteton këtë përcaktim gramatikor: të gjithë mbiemrat e mbledhur (*të përhershëm, të përgjakshme, të përmallshme*) ndërtohen me nyjëzim, parashtesim e prapashtesim njëherazi me parashtesën *për-* dhe prapashtesën *-shëm* nga tema emërore, ndërsa formimet me prapashtesën *-t(ë)* nuk dalin.
të përhershëm (... kurse këta pestë do t'i kemi ***të përhershëm*** ...) f.16
të përgjakshme (... s'kanë bërë tjetër veçse kanë lojtur një lojë ***të përgjakshme*** ...) f.131
të përmallshme (... këngët e ashpra të burrave që të kujtonin rrokullisjen e muzgjeve në pjerrësitë malore dhe këngët e zgjatura, ***të përmallshme*** grarishte ...) f. 188

Në materialin e analizuar, prapashtesat *-al, -ik, -onjës, -tar* dhe *-iv* hasen në pak raste të formimit të mbiemrave. Përdorimi i tyre dëshmohet përmes shembujve të mëposhtëm: *arkitektoral, metalik, ritmike, irritonjëse, kërcënonjëse, zyrtare* dhe *kopjativ*.
arqitektoral (… në atë librin për Shqipërinë thuhej se gjithë kompleksi ***arqitektoral*** i gjysmës së Bulevardit ...) f.136
metalik (… do të isha kurioz të dija se sa ***metalik*** ka qenë me gruan e bukur të kolonelit …) f.24
ritmike (… dëgjohej goditja ***ritmike*** e kazmave në tokën e fortë …) f.70
irritonjëse (... i fundosur i tëri në dritën indifirente, të përqarë e ***irritonjëse*** të hënës ...) f.47
kërcënonjëse (... ai kish vështruar pamjen ***kërcënonjëse*** të maleve ...) f.7
zyrtare (... pamja e rreptë dhe ***zyrtare*** e gjeneralit e bëri që ta lëjë frazën përgjysmë ...) f.32
kopjativ (... një copë letër ku kish vizatuar me kalem ***kopjativ*** diçka që i ngjante kishës...) f.32

Formimi i mbiemrave me paranyjëzim dhe prapashtesat: -t, -ët, -të

Mbiemra të formuar nga tema fjalëfomuese emërore me prapashtesat -ët, -të, -t janë: *të gurtë (të gur +të), i hekurt (i hekur +t), të llamarinta (të llamarinë +ta), e mermerta (e mermer+ta), të rregullta (të rregull+ta), e sfungjerta (e sfungjer+ta), i zjarrtë (i zjarr+të).*
të gurtë (... mbase u vinte çudi se si u gjendën ashtu papritur në këtë qytet të çuditshëm ***të gurtë*** ...) f.62
i hekurt (... shtyu me bastun portën ***e hekurt*** të shtëpisë publike dhe hyri brenda ...) f.67
të llamarinta (... tabelat ***e llamarinta*** të ndryshkura, kryeqt, shenjat ...) f.25
e mermerta (... zbritën ngadalë e pa folur nëpër shkallët ***e mermerta*** ...) f.226
të rregullta (... ata nuk kanë harta dhe shënime ***të rregullta*** ...) f.142

e sfungjerta (... po e kullonte dritën e saj nëpër shtresat ***e sfungjerta*** të reve e të mjegullës ...) f.46
i zjarrtë (... atij iu duk se ky rreth ishte ***i zjarrtë*** ...) f.194
Nga tema fjalëformuese ndajfoljore me pranyjëzim dhe prapashtesim janë formuar mbiemrat: *të njëllojtë, të rrumbullaktë*, *të shumtë*.
të njëllojtë (... emrat e tyre duhet të ishin të gjithë ***të njëllojtë*** ...) f.26
të rrumbullaktë (... në qendër të parkut, pranë pistës ***së rrumbullaktë*** të vallëzimit ...) f.127
e shumtë (... nga xhami i makinës shihte kalimtarë ***të shumtë*** ...) f.9 f.13
Nga tema foljore të vetës së parë të kohës së tashme në roman janë hasur mbiemrat: *e lagëta, të mprehta, e shkrifët.*
e lagëta (... ishin vënë grumbull njëra mbi tjetrën karriget ***e lagëta*** dhe pista dukej e madhe ...) f.127
të mprehta (... majat e tyre ***të mprehta*** dukej sikur do të gërrcinin ...) f.8
e shkrifët (... ato ishin përzier me dheun ***e shkrifët*** dhe dukeshin si copa drunësh ...) f.16
Në veprën e Kadaresë, mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve janë mjaft të pranishëm. Te këta mbiemra, nyja luan një rol të dyfishtë: shërben si element fjalëformues, por njëkohësisht shpreh edhe gjininë dhe numrin. Megjithëse nyja është kryesisht element gramatikor, ajo merr funksion fjalëformues në rastet kur merr pjesë në formimin e mbiemrit nga pjesorja (Agalliu et al., 2002: 69).
Kjo mënyrë formimi dëshmohet në roman përmes një numri mbiemrash, si: *e amshuar (amshoj - amshuar), e braktisur (braktis - braktisur), i dërrmuar (dërrmoj - dërrmuar), i fshehur (fsheh - fshehur), i fundosur (fundos - fundosur), të infektuar (infektoj - infektuar), të lehtësuar (lehtësoj - lehtësuar), e hapur (hapa - hapur), i heshtur (hesht - heshtur), të humbur (humb - humbur), i kërrusur (kërrus - kërrusur), të mallëngjyer (mallëngjej - mallëngjyer), i mallkuar (mallkoj - mallkuar), e masakruar (masakroj - maskaruar), të menduar (mendoj - menduar), i mpirë (mpij - mpirë), i nemitur (nemit - nemitur), e nderuar (nderoj - nderuar), e ndërtuar (ndërtoj - ndërtuar), e ndryshkur (ndyshk – ndyshkur), i ngarkaur (ngarkoj – ngarkuar), i ngrysur (ngrys – ngrysur), i përkulur (përkul – përkulur), të përmbledhur (përmbledh – përmbledhur), e përvëluar (përvëloj – përvëluar), e skalitur (skalis – skalitur), e shëmtuar (shëmtoj – shëmtuar), i shkujdesur (shkujdesem – shkujdesur), i shqetësuar (shqetësoj – shqetësuar), e shtrembëruar (shtrembëroj – shtrembëruar), të shurdhur (shurdhoj – shurdhur), i tepruar (teproj – tepruar), i tronditur (trondit – tronditur), i turbulluar (turbulloj – turbulluar), të zbardhur (zbardhoj – zbardhuar), të zbërdhulur (zbërdhul – zbërdhulur), të zgjatura (zgjas – zgjatur), e zvargur (zvarg – zvargur), të zverdhura (zverdhoj – zverdhur), të zhytur (zhyt – zhytur).*
e amshuar (... dhe drita ***e amshuar*** i ndrittë ata, përsëriti ai me vete pasi ra në gjunjë ...) f. 214
e bratktisur (... më duket vetja si ai prindi që rrit fëmijët ***e braktisur*** ...) f.24
të dërrmuar (... gjenrali e ndiente veten ***të dërrmuar*** ...) f.127
i fshehur (... njëzet vjet mikrobi qëndron ***i fshehur*** nën tokë dhe papritur shpërthen...) f.169
i fundosur (... qëllonin net të tilla vjeshte ku qielli bëhej i çuditshëm, ***i fundosur*** i tëri në dritën indifirente ...) f.47
të infektuar (... ka mundësi që në autokolonë të kishte shumë ushtarë ***të infektuar*** ...) f.169
të lehtësuar (... gjenerali e ndjeu veten më ***të lehtësuar*** ...) f.8
e hapur (... porta e shtëpisë qe ***e hapur*** dhe në strehën e saj të gjerë kish njerëz ...) f.186
i heshtur (... Gjenerali ktheu kokën nga prifti, që vështronte ***i heshtur*** në xham ...) f.8
të humbur (... gjenerali e vështroi me sy ***të humbur*** ...) f.217
i kërrusur (... e hodhi ngadalë thesin në krahë dhe doli nga dera përjashta në shi, ***i kërrusur*** e i mpirë ...) f.202
të mallëngjyer (... ata u ulën në tryezë ballë për ballë dhe po e vështronin me sy ***të mallëngjyer*** njëri-tjetrin ...) f.236

i mallkuar (po nuk do të tregoj asgjë për të mos prishur gëzimin e të tjerëve, qoftë edhe gëzimin tënd, ***i mallkuar*** ...) f. 191
e masakruar (... ashtu mbetej ***e masakruar*** derisa të binte dëbëora e re ...) f.177
të menduar (... qe mbështetur mbi bishtin e kazmës dhe shikonte me një vështrim ***të menduar*** ...) f.12
të mvrenjtur (... po ç'të bënte me këtë prift të ***mvrenjtur*** ...) f.21
i mpirë (... vështrimi i tij ***i mpirë*** u ndal një hop te vetura ...) f.19.
i nemitur (herë dremiste herë rrinte si ***i nemitur*** në kolltukun e prapsëm ...) f.49
e nderuar (... fjalët që i tha një zonjë e madhe ***e nderuar*** ...) f.8
e ndërtuar (... kjo ishte një rrugë strategjike ***e ndërtuar*** nga austriakët ...) 159
e ndryshkur (... ka mundësi ngandonjë kopsë ***e ndryshkur*** kapote, ose nga ndonjë eshtër e thyer ...) f.168
i ngarkuar (... një gjeneral i huaj dhe për më tepër ***i ngarkuar*** me një mision qeveritar ...) f.21
i ngrysur (... rrinte gjithë ditën ***i ngrysur***, i heshtur e i menduar dhe sa vinte dobësohej e zverdhej në fytyrë ...) f.66
i përkulur (... duke i tteguar me dorë diçka, ***i përkulur*** i tëri te buza e gropës ...) f.15
të përmbledhur (… asgjë tjetër nuk më kujtonte në mënyrë kaq ***të përmbledhur*** dhe të qartë ditëst e paqes …) f.113
e përvëluar (... ai shëtiste shpesh me Betin mbi rërën ***e përvëluar*** ...) f.76
e skalitur (... ata ishin afruar te varri dhe kishin lexuar mbishkrimin ***e skalitur*** ...) f.57
e shëmtuar (… çdo gjë bëhej ***e shëmtuar***, cipa e bukur gjymtohej, hapej si page vende-vende …) f.177
i shkujdesur (… ai mund të ndiqte ***i shkujdesur*** zhvillimin e dasmës dhe mund të pinte sa të donte …) f.193
i shqetësuar (… gjenerali e vështroi në sy ***i shqetësuar*** …) f.14
e shtrembëruar (… ai pa fytyrën ***e shtrembëruar*** nga urrejtja dhe nuk kuptoi asgjë …) f.196
të shurdhur (… kazma lëshoi një tingull ***të shurdhur*** …) f.12
i tepruar (… gjithë ky pasion ***i tepruar*** për burrin e vdekur njëzet vjet më parë …) f.76
i tronditur (… mendoi ***i tronditur*** gjenrali …) f. 12
i turbulluar (… nuk është ashtu, - i thashë ***i turbulluar***, - unë vetë nuk dua të luftoj …) 95
të zbardhur (… sikur të më shihnin kështu siç jam, mua, ish-ushtarin e "hekurt", të ngjyer e të ***zbardhur*** nga mielli …) f.94
të zbërdhulur (... flokë ***të zbërdhulur*** nga dielli, lëkurë e rreshkur ...) f.41
të zgjatura (... ka diçka gërryese në këto këngë ***të zgjatura***, të zgjatura, tha gjenerali ...) f.82
e zvargur (... kënga vinte ***e zvargur*** dhe e ngadaltë dhe isua e mbështillte nga të gjitha anët ...) f.80 Kadare e përdor e dhe si folje , si ***zvargej*** përjashta kënga ***zvargej***, sikur do të këputej, pastaj prapë gjallërohej ...) f.81
të zverdhura (... u ngjan atyre librave të vjetra me fletë ***të zverdhura*** e të pluhurosura ...) f.92
të zhytur (... gjenerali vështroi prapë mëngën boshe ***të zhytur*** në xhepin e thellë të xhaketës ...) f.233
Isamil Kadare, si mjeshtër i fjalës, përdor edhe forma mbiemërore të veçanta, si *i hirnosur* dhe *e përsëndyer*, të cilat tërheqin vëmendjen nga pikëpamja fjalëformuese.
Veçojmë mbiemrin *i hirnosur*, i cili mund të shpjegohet si formim analogjik sipas modelit të mbiemrave prejpjesorë me prapashtesën -ur, megjithëse në shqipe nuk ekziston folja hirnos.
e hirnosur (... nisi t'ja dëbonte përherë e më shumë pamjen ***e hirnosur*** e kërcënonjëse të maleve...) f.11
e përsëndyer (… na dukej si diçka e huaj, ***e përsëndyer*** dhe e turpëruar për jetë …) f.63
Mbiemrat *të përthyera* dhe *të zhveshura* janë përfshirë në grupin e mbiemrave të formuar me paranyjëzim të pjesores, ndonëse, në pamje të parë, mund të krijojnë përshtypjen e formimeve me parashtesim. Në përcaktimin e mënyrës së formimit të këtyre mbiemrave duhet bërë dallimi

ndërmjet formimit parashtesor dhe mbiemërzimit të pjesoreve. Në rastin konkret, mbiemrat *i/e përthyer* dhe *i/e zhveshur* nuk janë formuar me anë të parashtesimit të mbiemrave të tjerë, por nëpërmjet nyjëzimit të pjesoreve të foljeve *përthyej* dhe *zhvesh*. Për këtë dallim tërheq vëmendjen edhe Thomai (2002: 156), i cili thekson se mbiemrat e tipit *i përdredhur, i përhapur* etj. nuk janë formime parashtesore nga mbiemrat përkatës, por mbiemërzime të pjesoreve të foljeve prej të cilave rrjedhin.

të përthyera (… konturet e tokës së huaj i shihte ***të përthyera*** e të shtrembëruara …) f.9

të zhveshur (… faqe pllajash ***të zhveshura***, një mori gurësh të vegjël …) f.37

Denduria e përdorimit të mbiemrave të përbërë në romanin "Gjenrali e ushtrisë së vdekur" është mjaft e ulët. Janë hasur vetëm disa mbiemra të tillë, të formuar nga tema të ndryshme fjalëformuese, si: *emër + emër, emër + mbiemër, emër + pjesore dhe përemër i pacaktuar që tregon sasi + mbiemër me prapashtesën -sh*.

bojëhiri (… prifti e vështroi gjatë me sytë e tij ***bojëhiri*** dhe gjenerali e ndjeu veten keq …) f.198

fatzezë (… kjo ishte një gjë krejt e ndyshme, shumë më e thellë, më e trishtueshme dhe më ***fatzezë*** se ato …) f.62

hijerëndë (… salloni ishte ***hijerëndë*** me perdet e errëta …) f.19

kokulur (… gjenerali ndjeu prapë muzgjet që rrokulliseshin nëpër male dhe këngën e përmallshme ***kokulur*** grarishte …) f.200

shumëngjyrëshe (… dritat ***shumëngjyrëshe*** hynin të prera rrypa-rrypa nëpërmjet grilave …) f.225

Përfundim

Nga analiza fjalëformuese e materialit gjuhësor të vjelë nga romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dalin këto përfundime:

Produktiviteti i elementeve fjalëformuese:

- Parashtesimi: Parashtesa mohuese/përjashtuese *pa-* është mjeti më produktiv parashtesor. Ajo lidhet kryesisht me tema prejpjesore (*e pabanuar, të palarë, të panjohur*) ose me tema mbiemërore të prejardhura me prapashtesë (*të pabesueshme, të pagabueshme*).
- Paranyjëzimi dhe prapashtesimi: Prapashtesa *-shëm* del mjaft prodhimtare te mbiemrat e formuar me prapashtesim dhe nyjëzim. Kjo prapashtesë bashkohet me tema fjalëformuese emërore (*të frikshme, të fuqishme*), me tema foljore që mbarojnë me bashkëtingëllore kanë si temë fjalëformuese pjesoren e foljes, pa prapashtesat *-r(ë)* ose *-ur* (*të bezdisshme, e çuditshme*) dhe ndajfoljore (*e brendshme, të sotshëm*).

Mbiemërzimi i pjesoreve dhe funksioni i nyjës:

- Mbiemrat e prejardhur nga pjesoret përbëjnë një grup me denduri mjaft të lartë (*e amshuar, i dërrmuar, i mpirë, të infektuar*). Te këta mbiemra, nyja e paravendosur shërben si mjet fjalëformues (shndërron pjesoren në mbiemër).
- Mbiemrat *të përthyera* dhe *të zhveshura* nuk janë formime parashtesore nga mbiemra të tjerë, por rrjedhin drejtpërdrejt nga mbiemërzimi i pjesoreve të foljeve *përthyej* dhe *zhvesh* (sipas përcaktimit teorik të J. Thomait).

Prapashtesat me prodhimtari më të ulët dhe formimet analogjike:

- Prapashtesat *-ës, -(ë)sor, -or(e)* dhe *-të/-ët/-t* kanë një përfshirje më të kufizuar, krahasuar me prodhimtarinë e lartë të prapashtesës *-shëm*.
- Prapashtesat *-al, -ik, -onjës, -tar, -iv* përdoren në pak raste (*arkitektoral, metalik, irritonjëse, kopjativ*).

- Mbiemri *i hirnosur* përbën një formim analogjik sipas modelit të mbiemrave prejpjesorë me *-ur*, megjithëse folja bazë *hirnos* nuk gjendet në leksikun e gjuhës shqipe.

Kompozimi (përbërja):

- Mbiemrat e përbërë (kompozitat) kanë një denduri mjaft të ulët në vepër. Janë evidentuar vetëm pak modele fjalëformuese: emër+emër (*bojëhiri*), emër+mbiemër (*fatzezë, hijerëndë*), emër+pjesore (*kokulur*) dhe përemër+mbiemër (*shumëngjyrëshe*).

Analiza e përgjithshme dëshmon se pasurimi i leksikut mbiemëror në roman realizohet pothuajse tërësisht përmes *mënyrave derivative (parashtesim, prapashtesim, paranyjëzim dhe mbiemërzim i pjesoreve)*, ndërsa *kompozimi (përbërja)* luan një rol plotësisht dytësor.

Referencat

[1]. Agalliu, F., Engjëël, A., Shaban, D., et al (2002). Gramatika e gjuhës shqipe I. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Institutu I gjuhësisë dhe i Letërsisë.
[2]. Çabej, E. (1987). *Studime gjuhësore III*. Prishtinë: Rilindja.
[3]. Dhrimo, A. (1972). Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe. *Studime filologjike,* 3, 43-83.
[4]. Feka, Th. (1994). Veçori stukturore-semantike të mbiemrave me parashtesën pa- në gjuhën shqipe. *Studime filologjike*, 1-4, 41-54.
[5]. Haxhillazi, P. (1969). Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapshtesën *-shëm* në gjuhën shqipe. Stdime filologjike, 2, 91-100.
[6]. Thomai, J. (2002). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë.